

**Rekomandim CM/Rec(2014)3
i Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare
në lidhje me të dënuarit e rrezikshëm**

*(Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 19 shkurt 2014
në takimin e 1192-të të zëvendës ministrave)*

Komiteti i Ministrave, sipas kushteve të nenit 15b të Statutit të Këshillit të Europës,

duke pasur parasysh që qëllimi i Këshillit të Europës është arritja e unitetit më të madh mes anëtarëve të tij, sidomos nëpërmjet harmonizimit të ligjeve për çështje të interesit të përbashkët;

duke pasur parasysh qasjen specifike të nevojshme në lidhje me të dënuarit e rrezikshëm në burgjet e shteteve të tij anëtare;

duke pranuar sfidat me të cilat përballen Shtetet Europiane për balancimin e të drejtave të të dënuarve të rrezikshëm me nevojën për të ofruar siguri në shoqëri;

duke pasur parasysh rëndësinë e parimeve që përmban konventa dhe rekomandimet e mëparshme dhe sidomos;

- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (ETS nr.5);
- Konventa për Transferimin e të Dënuarve (ETS nr. 112);
- Konventa për Mbrojtjen e Fëmijëve kundër Shfrytëzimit Seksual dhe Abuzimit Seksual (CETS nr. 201);
- Rekomandimi Rec(82)17 i Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare në lidhje me ndalimin dhe trajtimin e të burgosurve të rrezikshëm;
- Rekomandimi Rec (92)17 i Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare në lidhje me koherencën në dhënien e dënimit;
- Rekomandimi Rec (97)12 i Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare për stafin që merret me zbatimin e sanksioneve dhe masave;
- Rekomandimi Rec (98)12 i Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare në lidhje me aspektet etike dhe organizative të kujdesit shëndetësor në burg;
- Rekomandimi Rec (2000)20 i Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare për rolin e ndërhyrjes të hershme psiko-sociale në parandalimin e kriminalitetit;
- Rekomandimi Rec (2000)22 i Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare për përmirësimin e zbatimit të rregullave europiane për sanksionet dhe masat komunitare;
- Rekomandimi Rec (2003)23 i Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare për menaxhimin nga administrata e burgjeve të të dënuarve me dënim me vdekje dhe burgim afatgjatë;
- Rekomandimi Rec (2004)10 i Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe dinjitetin e personave me çrregullime mendore;
- Rekomandimi Rec (2006)2 i Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare për rregulloren europiane të burgjeve;
- Rekomandimi Rec (2008)11 i Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare për rregullat europiane për autorët e mitur që janë objekt i sanksioneve dhe masave;

- Rekomandimi Rec (2010)1 i Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare për Rregullat e Këshillit të Europës për Shërbimin e Provës;
- Rekomandimi Rec (2014)4 i Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare për mbikëqyrjen elektronike;

Duke pasur parasysh parimet kushtetuese, traditat ligjore dhe pavarësinë e gjyqësorit në Shtetet e tij Anëtare;

Duke pranuar që ky rekomandim nuk përmban detyrimin ndaj shteteve anëtare që të prezantojnë ndalimin parandalues të sigurt ose mbikëqyrjen parandaluese në legjislacionin kombëtar;

Duke pranuar që ky rekomandim mund të zbatohet në përputhje me legjislacionin kombëtar *mutatis mutandis* në raste të tjera të ndryshme nga ato të përmendura në këtë rekomandim;

Duke pranuar që një gamë e madhe e autoriteteve dhe agjencive merren me të dënuarit e rrezikshëm dhe që këto organe kërkojnë një tërësi koherente parimesh orientuese në përputhje me standardet e Këshillit të Europës;

Rekomandon që Shtetet Anëtare të Këshillit të Europës:

- të orientohen në legjislacionin, politikat dhe praktikën e tyre nga rregullat që përmban shtojca e këtij rekomandimi;
- të sigurojnë që ky rekomandim dhe relacioni i tij shoqëruet të përkthehen dhe t'i shpërndahen të gjitha autoriteteve përkatëse, agjencive, profesionistëve dhe shoqatave që merren me të dënuarit e rrezikshëm, si edhe vetë këtyre autorëve.

Shtojca e Rekomandimit CM/Rec (2014) 3

Pjesa I- Përkufizime dhe parime bazë

Përkufizime

1. Për qëllim të këtij rekomandimi:

a. **I dënuar i rrezikshëm** është një person që është dënuar për një krim shumë të rëndë të dhunshëm ose seksual kundër personave dhe që ka shumë mundësi të përsërisë krime të tjera shumë të rënda të dhunshme ose seksuale.

b. **Dhunë** mund të përkufizohet si përdorimi i qëllimshëm i forcës fizike, pra kërcënimi për përdorimin e forcës ose aktual, kundër personave, që rezulton ose ka mundësi të rezultojë në plagosje, dëm psikologjik ose vdekje. Ky përkufizim identifikon katër mënyra me anë të të cilave mund të shkaktohet dhunë: sulm fizik, seksual dhe psikologjik dhe heqje e lirisë.

c. **Risk** përkufizohet si mundësia e madhe për një shkelje shumë të rëndë të dhunshme ose seksuale kundër personave.

d. **Vlerësim i riskut** është procesi me anë të të cilit kuptohet risku: analizohet natyra, rëndesa dhe forma e shkeljes; identifikohen karakteristikat e autorëve dhe rrethanat që kontribuojnë tek ato; merret vendimi bazuar në informacion dhe veprohet me qëllim reduktimin e riskut.

e. **Menaxhim i riskut** është procesi i përzgjedhjes dhe aplikimit të një sërë masash ndërhyrjeje në kontekst burgu dhe në komunitet dhe në periudhën pas lirimit ose në kontekst të mbikëqyrjes parandaluese, me qëllim reduktimin e riskut të krimit shumë të rëndë të dhunshëm ose seksual kundër personave.

f. **Trajtimi** përfshin, por jo vetëm, kujdesin mjekësor, psikologjik dhe/ose social për qëllime terapeutike. Mund të shërbejë për të ulur riskun që paraqet personi dhe mund të përfshijë masa për të përmirësuar dimensionin social të jetës së të dënuarit.

g. **Ndalimi parandalues të sigurt** do të thotë ndalim i vendosur nga autoriteti gjyqësor ndaj një personi, që duhet të vuhet gjatë ose pas periudhës së caktuar të burgimit në përputhje me legjislacionin e tij kombëtar. Nuk vendoset vetëm për shkak të një shkeljeje të kryer në të shkuarën, por edhe në bazë të një vlerësimi që tregon se ai ose ajo mund të kryejnë një tjetër vepër shumë të rëndë në të ardhmen.

h. **Mbikëqyrje parandaluese** do të thotë masë kontrolli, monitorimi, mbikëqyrje ose kufizimi e lëvizjes ndaj një personi pas kryerjes prej tij/saj të një krimi dhe pas vuajtjes së dënimit me burg prej tij/saj ose në vend të kësaj të fundit. Nuk vendoset vetëm për shkak të një shkeljeje të kryer në të shkuarën, por edhe në bazë të një vlerësimi që tregon se ai ose ajo mund të kryejnë një tjetër vepër shumë të rëndë në të ardhmen.

Fusha e zbatimit, zbatimi dhe parimet bazë

2. Ky rekomandim nuk zbatohet për:

- a. fëmijët;
- b. personat me çrregullime mendore që nuk janë nën përgjegjësinë e sistemit të burgjeve;

3. Autorët e rrezikshëm, ashtu si të gjithë autorët, duhet të trajtohet me respekt për të drejtat dhe liritë e tyre themelore dhe me konsideratën e duhur për situatën e tyre të veçantë dhe nevojat individuale duke mbrojtur prej tyre në të njëjtën kohë me efektivitet shoqërinë.

4. Çdo vendim që mund të rezultojë në heqjen ose kufizimin e lirisë së një autori të rrezikshëm do të vendoset ose miratohet nga autoriteti gjyqësor. Masat kufizuese dhe ndërhyrëse nuk duhet të jenë në disproporcion me nivelin e riskut dhe duhet të zbatohet masa më pak kufizuese koherente me mbrojtjen e publikut dhe reduktimin e riskut.

5. Respektimi i kujdesshëm i kritereve për të identifikuar "të dënuarit e rrezikshëm" duhet të marrë parasysh që ky grup është pakicë e vogël e të gjithë popullatës së të dënuarve, megjithatë pa kompromentuar sigurinë publike. Këto kritere duhet të përfshijnë fakte të krimit të rëndë me dhunë të kryer më përpara, kryerjen e krimeve seksuale, karakteristikat e autorit ose veprës së tij/saj që tregojnë mundësinë e riskut të vazhdueshëm dhe të konsiderueshëm për dhunë, ose vepra seksuale, si edhe prova të pamjaftueshmërisë së masave më të lehta, si për shembull mosrespektimi i mëparshëm nga autori i këtyre masave dhe kryerja e vazhdueshme e veprës penale, pavarësisht zbatimit të masave më të lehta. Kohëzgjatja e dënimit ose recidivizmi i përgjithshëm i të dënuarit nuk mund të jenë të vetmet kritere për të përcaktuar një dënuar si të rrezikshëm në këtë kuptim.

6. Menaxhimi i riskut i autorëve të rrezikshëm, sipas rastit, duhet të ketë qëllimin afat-gjatë të riintegrit të tyre të sigurt në komunitet në përputhje me kushtet për mbrojtjen e publikut nga rreziku që paraqet i dënuari. Kjo duhet të përfshijë një plan individual që përmban një proces me faza të rehabilitimit nëpërmjet ndërhyrjes së duhur.

7. Hapa pozitive duhet të merren për të shmangur diskriminimin dhe stigmatizimin dhe për të trajtuar problemet specifike me të cilat mund të përballen të dënuarit gjatë qëndrimit në burg dhe kur i nënshtrohen mbikëqyrjes parandaluese në komunitet.

8. Mbrojtja e të drejtave të të dënuarve të rrezikshëm, duke pasur parasysh ligjshmërinë e ekzekutimit të masave (ndalim parandalues i sigurt, mbikëqyrje parandaluese) duhet të sigurohet me anë të monitorimit të rregullt dhe të pavarur, sipas rregulloreve kombëtare, nga një autoritet gjyqësor ose organ tjetër i pavarur i autorizuar për t'i vizituar dhe që nuk i përket administratës së burgjeve.

9. Nevojat specifike të të dënuarve të rrezikshëm në lidhje me riskun duhet të trajtohen gjatë gjithë periudhës së ndërhyrjes dhe burime të mjaftueshme duhet të alokohen për të trajtuar me efektivitet situatën e veçantë dhe nevojat specifike.

10. Vlerësimi i riskut dhe praktikat e menaxhimit duhet të bazohen në prova.

11. Efektiviteti i menaxhimit të riskut dhe menaxhimi i të dënuarve të rrezikshëm duhet të vlerësohet duke inkurajuar dhe financuar kërkimin që do të përdoret për të orientuar politikën dhe praktikën brenda fushës. Mjetet e vlerësimit të riskut duhet të vlerësohen me kujdes për të identifikuar aspektin kulturor, gjinor dhe social.

12. Trajnimi i duhur për vlerësimin dhe trajtimin e autorëve të rrezikshëm duhet të parashikohet për autoritetet përkatëse, agjencitë, profesionistët, shoqatat dhe stafin e burgjeve për të siguruar që praktika të përputhet me standardet më të larta etike dhe profesionale kombëtare dhe ndërkombëtare. Nevojiten kompetenca të veçanta për trajtimin e të dënuarve ve që vuajnë nga një çrregullim mendor.

Pjesa II- Vendimet gjyqësore për autorët e rrezikshëm

Dispozita të përgjithshme

13. Vlerësimi i riskut duhet të bëhet nga autoriteti gjyqësor.

14. Autori i dyshuar i rrezikshëm duhet të ketë mundësi të kërkojë një raport të veçantë ekspertize.

15. Autoriteteve gjyqësore, kur është e mundur dhe e duhur, duhet t'u jepen raporte para-dënimit për rrethanat personale të të dënuarit për të cilin vlerësohet rrezikshmëria.

Ndalim parandalues i sigurt

16. Vendimi i një autoriteti gjyqësor për të vendosur ndalimin parandalues të sigurt kundër një të dënuari të rrezikshëm duhet të marrë parasysh raportin e vlerësimit të riskut nga ekspertët.

17. Një i dënuar i rrezikshëm duhet të mbahet në ndalim parandalues në bazë të një vlerësim që përcakton që ai ose ajo ka shumë mundësi që të kryejë në të ardhmen një krim shumë të rëndë të dhunshëm ose seksual kundër personave.

18. Ndalimi parandalues i sigurt justifikohet vetëm nëse përcaktohet si masa më pak kufizuese e nevojshme.

19. Kur ndalimi parandalues i sigurt merr formën e ndalimit përtej periudhës së përcaktuar për dënimin, është thelbësore që personat e ndaluar të kenë mundësi të kundërshtojnë ndalimin, ose kufizimin e lirisë së tyre, përpara një gjykate të paktën çdo dy vjet pas mbarimit të periudhës së caktuar për dënimin.

20. Kushdo që ndalohet për arsye parandaluese duhet të ketë të drejtën e një plani të shkruar që i jep mundësi të trajtojë faktorët specifikë të riskut dhe karakteristika të tjera që kontribuojnë në klasifikimin e tyre aktual si të dënuar të rrezikshëm.

21. Qëllimi i autoriteteve përkatëse duhet të jetë reduktimi i kufizimit dhe lirimi nga ndalimi parandalues i sigurt në përputhje me mbrojtjen e publikut nga risku që paraqet autori.

22. Të dënuarit e rrezikshëm në ndalimin parandalues të sigurt, pas mbarimit të periudhës së përcaktuar për dënimin duhet të mbahen në kushtet e duhura sipas kërkesave të menaxhimit të riskut, sigurisë dhe mbrojtjes së publikut. Në çdo rast, duhet të garantohet respektimi i dinjitetit të njeriut.

Mbikëqyrja parandaluese

23. Mbikëqyrja parandaluese mund të zbatohet si një alternativë e ndalimit parandalues të sigurt, si kusht për lirim me kusht, ose pas liritimit, dhe duhet të rishikohet rregullisht.

24. Kjo mbikëqyrje mund të përbëhet nga një ose më shumë masat e mëposhtme të përcaktuara nga autoriteti kompetent:

- i. paraqitje e rregullt në një vend të caktuar;
- ii. komunikimi i menjëhershëm i ndryshimit të vendbanimit, punës ose pozicionit në mënyrën dhe brenda afateve të caktuara;
- iii. ndalimi i largimit pa autorizim nga vendbanimi ose një territor;
- iv. ndalimi i afrimit ose kontaktimit të viktimës, ose të afërmeve të tij ose personave të tjerë të autorizuar;
- v. ndalimi i vizitave në vende të caktuara, vende ose institucioneve;

- vi. ndalimi i qëndrimit në vende të caktuara;
- vii. ndalimi i kryerjes së disa veprimtarive që mund të ofrojnë mundësinë për të kryer krime të natyrës së ngjashme;
- viii. pjesëmarrje në programe trajnimi ose veprimtari profesionale, kulturore, edukative ose të ngjashme;
- ix. detyrimi për të marrë pjesë në programe ndërhyrjeje dhe për t'ju nënshkruar rivlerësimin të rregullt, sipas nevojës;
- x. përdorimi i pajisjeve elektronike që mundësojnë mbikëqyrje të vazhdueshme (mbikëqyrje elektronike) në lidhje me një ose disa nga masat e mësipërme;
- xi. masa të tjera të parashikuara në legjislacionin kombëtar.

25. Kur bëhet fjalë për mbikëqyrje të papërcaktuar në kohë ose afatgjatë, garancitë e duhura për zbatimin e drejtë të kësaj mase duhet të udhëhiqen nga parimet që përmban Rekomandimi Rec (2000)22 për përmirësimin e zbatimit të rregulloreve europiane për sanksionet dhe masat komunitare.

Pjesa III- Parimi i vlerësimit të riskut gjatë zbatimit të një dënimi

26. Shtrirja e vlerësimit duhet të përcaktohet nga niveli i riskut dhe të jetë në proporcion me rëndesën e rezultatit të mundshëm.

27. Vlerësimi i riskut duhet të përfshijë një analizë të detajuar të sjelljeve të mëparshme dhe faktorëve historikë, personalë dhe rrethanorë që kanë çuar dhe kontribuar për atë. Ato duhet të bazohen në informacionin më të mirë në dispozicion.

28. Vlerësimi i riskut duhet të bëhet i bazuar në prova, në mënyrë të strukturuar, të përfshijë mjetet e vlerësuarat të duhura dhe vendimmarrje profesionale. Ata persona që marrin përsipër vlerësimin e riskut duhet të jenë në dijeni të dhe të shprehin qartë kufizimet e tyre për vlerësimin e riskut për dhunë dhe për parashikimin e sjelljes së ardhshme, sidomos në periudhën afatgjatë.

29. Këto instrumente të vlerësimit të riskut duhet të përdoren për të zhvilluar interpretimin më konstruktiv dhe më pak kufizues të një mase ose sanksioni, si edhe për zbatimin e individualizuar të një dënimi. Ato nuk janë caktuar për të vendosur dënimin edhe pse gjetjet e tyre mund të përdoren në mënyrë konstruktive për të treguar nevojën për ndërhyrje.

30. Vlerësimet e kryera gjatë zbatimit të një dënimi duhet të shihen si progresive, dhe të rishikohen rregullisht për të lejuar ri-vlerësimin dinamik të riskut të autorit:

a. Vlerësimi i riskut duhet të përsëritet rregullisht nga staf i trajnuar për të plotësuar kërkesat e planifikimit të dënimit ose kur është e nevojshme, duke lejuar rishikimin e rrethanave që ndryshojnë gjatë ekzekutimit të dënimit.

b. Praktikrat e vlerësimit duhet t'i përgjigjen faktit që risku që paraqet kryerja e krimeve nga individi ndryshon me kalimin e kohës: ky ndryshim mund të jetë gradual ose i menjëhershëm.

31. Vlerësimet duhet të kombinohet me mundësitë për të dënuarit që të trajtojnë nevojat e tyre specifike të lidhura me riskun dhe që të ndryshojnë sjelljen dhe qëndrimin e tyre.

32. Të dënuarit duhet të përfshihen në vlerësim dhe të kenë informacion për procesin dhe akses në konkluzionet e vlerësimit.

33. Dallim i qartë duhet të bëhet ndërmjet risqeve të autorit në komunitetin e jashtëm dhe brenda në burg. Këto dy rreziqe mund të vlerësohen veçmas.

Pjesa IV- Menaxhimi i riskut

34. Ndërhyrjet për parandalimin e përsëritjes së krimit duhet të lidhen qartë me vlerësimin e vazhdueshëm të riskut të një të dënuarit të caktuar. Duhet të planifikohet si në burg ashtu edhe në komunitet, duke siguruar vazhdimësinë ndërmjet dy konteksteve.

35. Të gjitha planet e zhvilluara me këtë qëllim në mendje duhet të përfshijnë: masa rehabilitimi dhe kufizuese për të reduktuar mundësinë e përsëritjes në periudhën afatgjatë, duke ofruar nivelin e nevojshëm të mbrojtjes për të tjerët; masa për të mbështetur individin që të trajtohen nevojat personale; masa emergjente për t'ju përgjigjur menjëherë treguesve të kryerjes apo kryerjes së afërt të krimit; dhe mekanizmat e duhur për t'ju përgjigjur treguesve të ndryshimeve pozitive.

36. Ky plan duhet të lehtësojë komunikimin efektiv, të koordinojë veprimet e agjencive të ndryshme dhe të mbështesë bashkëpunimin ndërmjet agjencive përfshirë administratën e burgjeve, punonjësit e shërbimit të provës, shërbimet sociale dhe mjekësore dhe autoritetet e zbatimit të ligjit.

37. Planet duhet të jenë realiste dhe të kenë objektiva të matshme dhe duhet të strukturohen në mënyrë të tillë që lejon të dënuarin të kuptojë qartë qëllimet e ndërhyrjes dhe pritshmëritë e tij/saj.

38. Proceset e mësipërme duhet të rishikohen rregullisht, me mundësinë për t'ju përgjigjur ndryshimeve në vlerësimin e riskut.

39. Përveç këtyre rekomandimeve, menaxhimi i riskut në komunitet duhet të udhëhiqet nga parimet që përmban Rekomandimi CM/Rec(2010)1 për Rregulloren e Këshillit të Europës për Shërbimin e Provës dhe Rekomandimi Rec (2000) 22 për përmirësimin e zbatimit të rregullave europiane dhe sanksioneve komunitare mbi masat.

Pjesa V - Trajtimi dhe kushtet e burgimit të të dënuarve të rrezikshëm

Kushtet e burgimit

40. Burgimi, nëpërmjet heqjes së lirisë, është dënim në vetvete. Kushtet e burgimit dhe regjimet e burgjeve duhet të udhëhiqen nga parimet që përmban Rekomandimi Rec (2006)2 për Rregulloren Europiane për Burgjet.

41. Masat e sigurisë duhet të caktohen në minimumin e nevojshëm dhe niveli i sigurisë duhet të rishikohet rregullisht.

Trajtimi

42. Sa më shpejt që të jetë e mundur pas pranimit dhe pas vlerësimit të riskut, nevojat specifike të lidhura me riskun dhe karakteristikat e autorit, trajtimi i duhur në institucionin e përshtatshëm duhet të përgatiten nisur nga informacioni i siguruar për nevojat individuale të lidhura me riskun specifik, kapacitetin dhe vendimet. Kjo duhet të marrë parasysh afërsinë me të afërmit dhe kushtet specifike. Zbatimi duhet të mbikëqyret nga një autoritet kompetent.

43. Trajtimi mund të përfshijë kujdesin mjekësor, psikologji dhe/ose social.

44. Atyre që kanë, ose zhvillojnë, çrregullim mendor, duhet t'u ofrohet trajtim i duhur. Duhet të zbatohet udhëzimi që jep Rekomandimi Rec (98)7 në lidhje me aspekte etike dhe organizative të kujdesit shëndetësor në burgje. Shërbimi mjekësor ose psikiatrik i institucioneve penale duhet të ofrojë ose lehtësojë trajnimin mjekësor dhe psikiatrik të të gjithë autorëve të rrezikshëm që kanë nevojë për këtë trajtim.

45. Qëllimi i trajtimit të autorëve të rrezikshëm duhet të jetë ruajtja e shëndetit dhe vetë-respektimit të tyre dhe, në masën që e lejon kohëzgjatja e dënimit, zhvillimi i ndjenjës së tyre të përgjegjësisë dhe inkurajimi i sjelljeve dhe aftësive që do t'i ndihmojnë të bëjnë në përputhje me ligjin dhe të pavarur financiarisht.

Puna, arsimi dhe aktivitete të tjera të rëndësishme

46. Personat nën ndalimin parandalues të sigurt duhet të kenë akses në veprimtari të rëndësishme dhe në punësim dhe arsim sipas parimeve të Rekomandimit Rec (2006) 2 për Rregulloren Europiane për Burgjet.

Personat e pambrojtur

47. Administrata e burgjeve duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë nevojave të veçanta të të dënuarve të moshuar dhe edukimit të të dënuarve të rinj.

Pjesa VI- Monitorimi, stafi dhe kërkimi

48. Stafi dhe agjencitë që merren me të dënuar të rrezikshëm duhet t'i nënshtrohen inspektimit të rregullt nga qeveria dhe mbikëqyrjes së pavarur.

49. I gjithë stafi, përfshirë autoritetet përkatëse, agjencitë, profesionistët dhe shoqatat e përfshira në vlerësim dhe trajtim të të dënuarve të rrezikshëm duhet të përzgjidhet në bazë të aftësive dhe kompetencave të caktuara dhe të mbikëqyrret në mënyrë profesionale. Ata duhet të kenë burimet e mjaftueshme dhe të trajtohen për vlerësimin dhe trajtimin e nevojave specifike, faktorët e riskut dhe kushtet e këtij grupi. Nevojiten kompetenca të veçanta për trajtimin e të dënuarve ve që vuajnë nga një çrregullim mendor.

50. Trajnimi në bashkëpunimin mes disa agjencive ndërmjet stafit brenda dhe jashtë burgjeve duhet të organizohet.

51. Studimi për përdorimin dhe zhvillimin e mjeteve të besueshme të vlerësimit të nevojave dhe riskut duhet të ndërmerret duke ju referuar në veçanti autorëve të rrezikshëm.

52. Studim vlerësues duhet të bëhet për të përcaktuar cilësinë e vlerësimit të riskut.

Pjesa VII- Vijueshmëria

Komiteti European për Problemet e Krimin (CDPC) duhet të luajë rol të rëndësishëm në zbatimin efektiv të këtij rekomandimi. Ai duhet të bëjë propozim për të lehtësuar ose përmirësuar përdorimin e tij të çmuar. CDPC duhet të përfshijë identifikimin e çdo problemi. Gjithashtu duhet të lehtësojë mbledhjen, analizimin dhe shkëmbimin e informacionit, përvojës dhe praktikës së mirë ndërmjet shteteve.